

SKK për OJF

Udhëzues për zbatim

I ndryshuar Shtator 2018

UZ 1 Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse (SKK për OJF) është strukturuar në tre seksione, si më poshtë:

Seksioni I ka të bëjë me përmbajtjen e përgjithshme, objektivat e pasqyrave financiare si dhe përkufizimet kryesore të elementeve të pasqyrave financiare.

Seksioni II ka të bëjë me formën dhe përmbajtjen e tre pasqyrave kryesore të prodhuara nga OJF-të.

Seksioni III ka të bëjë me kërkesat e kontabilitetit në lidhje me kontributet e përfuara ose të gjeneruara nga OJF-të.

UZ 2 Standardi përshkruan objektivin e pasqyrave financiare (paragrafi 5), cilësitë që i bëjnë pasqyrat financiare të dobishme për përdoruesit (paragrafët 6-10), përmbajtja e kërkuar e pasqyrave financiare kryesore (paragrafët 11 deri 68) dhe mënyrën sesi kontributet do të kontabilizohen (paragrafët 69 deri në 100).

Seksioni mbi kontributet mbulon: Kontributin në mjete monetare, aktive të tjera, premtimet në mjete monetare apo aktive dhe mbledhjen e kontributeve.

UZ 3 Standardi thekson (paragrafi 3) ekzistencën e disa koncepteve dhe parimeve të cilat ndikojnë në përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve, të cilat dallojnë nga konceptet dhe parimet e pasqyrave financiare të njësive ekonomike fitimprurëse. Këto dallime janë pasqyruar në kërkesat për hartimin e pasqyrave financiare të përcaktuara në standardin për OJF-të. Konceptet e përgjithshme dhe parimet që nuk janë përmendur në mënyrë specifike në standard mund të supozohet të jenë të zbatueshme si për OJF-të ashtu edhe për njësitë ekonomike fitimprurëse. Për shembull, konceptet e kontabilitetit si tillë si materialiteti, qendrueshmëria, krahasueshmëria, parimi i maturisë, etj, duhet të zbatohen edhe në përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve.

UZ 4 Standardi gjithashtu përcakton përkufizimin e njësive ekonomike 'jo-fitimprurëse' ose "OJF-të" (paragrafi 1) dhe natyrën e njësive ekonomike që aplikojnë këtë standard (paragrafi 4). Duhet të theksohet se standardi nuk është parashikuar të aplikohet në organizatat jo-fitimprurëse që janë pjesë e sektorit public. Për sa thuhet në paragrafin 4, standardi aplikohet në ato organizata që janë "as në pronësi as të kontrolluara nga qeveria". Kështu, ky standard nuk zbatohet nga agjencitë rregullatore të cilat megjithëse financohen nga njësi ekonomike private kontrollohen nga Qeveria. P.sh, rregullatori i energjisë financohet nga sektori i energjisë por vepron si një agjenci qeveritare. Këtyre organizatave i'u kërkohet të aplikojnë rregullimet kontabël të zbatueshme për njësitë e sektorit publik.

UZ 5 SKK për OJF-të ka dy dallime të thelbësishme me standardet e kontabilitetit të njërive ekonomike fitimprurëse:

- Një përkufizim të rishikuar të aktivitetit, mbështetur në supozimin se njësitë ekonomike jo fitimprurëse zotërojnë aktive që jo domosdoshmërisht mbahen për të gjeneruar mjete monetare (shih UZ 13 – UZ18);
- Një ndarje mes aktiveve të kufizuara dhe të pakufizuara si dhe fondeve dhe provizioneve, për kontabilizimin e aktiveve mbi të cilat janë vendosur kushte për përdorimin e tyre (shih UZ 69 - UZ 72)

UZ 6 Kështu, disa nga vendimet bazë që duhen marrë kur përgatiten pasqyrat financiare për njësitë ekonomike jofitimprurëse është vendimi nëse aktivi duhet njohur, me çfarë vlere duhet matur dhe nëse e ardhura duhet të njihet menjëherë apo si e ardhur e shtyrë deri sa kushti të jetë plotësuar. Ky udhëzim për zbatim përmban shembuj mbi situata të ndryshme që mund të krijohen dhe referenca e tyre tregohet në pemën e vendimit të dhënë në UZ 30.

PJESA 1

OBJEKTIVI I PASQYRAVE FINANCIARE

UZ 7 Paragrafi 5 i Standardit i referohet tri lloj informacionesh që pasqyrat financiare duhet t'u ofrojnë përdoruesve: rreth pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare. Kjo reflektohet në tre pasqyrat e shpjeguara në paragrafët 11 deri 68:

- Pasqyra e pozicionit financiar
- Pasqyra e aktiviteteve
- Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare.

UZ 8 Paragrafët 6-7 të Standardit përmendin një numër konceptesh themelore dhe parimesh që aplikohen në të gjithë standardin për të specifikuar përmbajtjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Kryesori është mundësimi i një "pamje të drejtë dhe të vërtetë". Në vend të përcaktimit të këtij termi në mënyrë specifike, standardi thjesht i referohet një shumëllojshmërie karakteristikash që kolektivisht ndihmojnë në mundësimin e një pamje të saktë dhe të vërtetë mbi pasqyrat financiare. Kjo mundësohet nga kërkesat që pasqyrat financiare duhet të jenë të 'sakta' dhe 'të plota' (në lidhje me ngjarjet ekonomike), "të arsyeshme" dhe "të logjikshme" (në lidhje me vlerësimet), dhe "të mjaftueshme" dhe "të detajuara" (në lidhje me shënimet e pasqyrave). Një pamje e drejtë dhe e vërtetë është arritur edhe me respektimin e kërkesave të ligjit mbi Kontabilitetin dhe kuadrin e përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SKK1.

UZ 9 Edhe pse standardi kryesisht i adresohet transaksioneve kryesore që kryen një OJF, pranohet në (paragrafët 8-10) se ekzistojnë dhe raste të rralla, ku një transaksion nuk është trajtuar në mënyrë specifike nga standardi ose ku pajtimi me standardin nuk do të rezultonte në një pamje të vërtetë, siç kërkohet nga pasqyrat. Në situata si këto, referimi duhet të bëhet tek SKK-të ose SNRF-të që trajtojnë çështjen përkatëse (paragrafi 9), ose nëse kjo nuk është e mundur, OJF-ja duhet të synojë të sigurojë që informacioni në pasqyrat financiare të jetë i përshtatshëm dhe t'u japë përdoruesve një pamje të vërtetë dhe të drejtë (paragrafi 10). Këto rrethana janë kaq të pazakonta sa është e vështirë për të dhënë shembuj. Gjithësesi, kjo kërkesë është përfshirë në standard mbi bazën e mundësisë së ekzistencës së një rrethane të tillë. Standardet kombëtare të kontabilitetit duhet të përfshijnë një dispozitë që lejon devijimin nga kërkesat e tyre, në mënyrë që të plotësohet kërkesa themelore që pasqyrat financiare të tregojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Prandaj, pjesës më të madhe të njësive ekonomike jofitimprurëse, do t'i kërkohet zbatimi korrekt i standardit gjatë gjithë kohës.

POZICIONI FINANCIAR DHE PERFORMANCA

UZ 10 Pozicioni financiar i një njësie ekonomike jofitimprurëse është përcaktuar nga aktivet, detyrimet dhe aktivet neto (të përcaktuara në paragrafin 11) në një datë të caktuar (p.sh. fundi i periudhës raportuese) ndërsa performanca e njësisë ekonomike jofitimprurëse përcaktohet nga marrëdhënia mes të ardhurave të saj dhe shpenzimeve (të përcaktuara në paragrafët 23-24) gjatë periudhës raportuese.

UZ 11 Pozicioni financiar i një OJF-je paraqitet në pasqyrën financiare, ndryshe të njohur si bilanci. Performanca financiare paraqitet në pasqyrën e aktiviteteve e cila ka disa ngjashmëri me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve që paraqitet nga njësitë ekonomike fitimprurëse. Këto dy pasqyra janë shqyrtuar më në hollësi respektivisht në paragrafët 29-39 dhe 40-64.

UZ 12 Elementet kryesorë të dy pasqyrave financiare janë diskutuar më tej në paragrafët 17 deri 24. Kjo pjesë e standardit është e një rëndësie themelore sepse përcakton kriteret për njohjen e aktiveve, detyrimeve, aktiveve neto, të ardhurave dhe shpenzimeve. Seksionet në vijim të paragrafëve 17 deri 24 (*p.sh.:* Seksioni II dhe Seksioni III i standardit) përqendrohen më shumë në prezantimin e zërave të pasqyrave financiare, por është e një rëndësie parësore që vetë elementet të jenë njohur, matur dhe vlerësuar në mënyrë korrekte para se të bëhet paraqitja e tyre në pasqyra.

ELEMENTET E PASQYRËS SË POZICIONIT FINANCIAR DHE PASQYRËS SË PERFORMANCËS FINANCIARE

UZ 13 Aktivi është përkufizuar në paragrafin 17 si "një burim ekonomik ose një e drejtë e kontrolluar nga OJF-ja, që: (a) është rezultat i ngjarjeve të shkuara; dhe (b) nga i cili priten në të ardhmen të rrjedhin tek njësi ekonomike raportuese përfitime ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve".

Shumë aktive (p.sh. tokat, ndërtesat, impiantet dhe pajisjet) kanë formë fizike dhe këtyre i'u referohemi si "aktive materiale". Megjithatë forma fizike nuk është thelbësore për ekzistencën e një aktivi; patentat dhe të drejtat e autorit, për shembull, janë aktive në qoftë se kontrollohen nga OJF-ja dhe në të ardhmen priten nga përdorimi i tyre të rrjedhin në njësinë ekonomike jofitimprurëse përfitime ekonomike apo të tjera përfitime të mundshme. Aktive të tilla quhen "aktive jo-materiale".

UZ 14 Në kontekstin e njohjes së aktiveve, OJF-ja duhet të shpjegojë çështjen e përfitimeve ekonomike apo llojeve të tjera të përfitimeve që rezultojnë nga përdorimi i aktiveve të saj. Përkufizimi i aktiveve në paragrafin 17 (informacion i cili përsërit paragrafin 13) fokusohet në këtë çështje. Dy llojet e përfitimit, janë ato referuar si 'përfitime ekonomike' dhe 'lloje të tjera të mundshme të përfitimeve'. Ky është një aspekt kyç në kontabilizimin e aktiveve në sektorin jofitimprurës, meqenëse aktivet nuk mbahen detyrimisht për aftësitë e tyre të gjenerimit të mjeteve monetare (si janë zakonisht në sektorin fitimprurës). Përveç ndikimit në evidentimin e aktiveve, koncepti 'lloje të tjera të mundshme të përfitimeve' ka ndikim në vlerësimin dhe zhvlerësimin e aktiveve të konsideruara si të tilla. Një OJF që ka një aktiv të veçantë të specializuar që përdoret për ruajtjen e objekteve kulturore mund ta njohë atë aktiv edhe nëse nuk ka vlerë të tregtueshme, pasi është i rëndësishëm për punën e vazhdueshme të bamirësisë.

UZ 15 Është e rëndësishme, gjithashtu, të theksohet se pronësia ligjore nuk është kërkesë për njohjen e një aktivi. Pra, disa zëra të aktivitetit edhe pse nuk janë në pronësi të një njësie ekonomike jofitimprurëse trajtohen si aktive në pasqyrën e pozicionit financiar të saj. Paragrafi 17 thekson faktin se është kontrolli dhe jo pronësia e një përdorimi ekonomik që përcakton nëse mund të njihet ose jo, si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar.

Shembulli 1

Një OJF merr me qira një makinë nga një kompani qiradhënëse. Afati i qirasë është sa vetë jeta ekonomike e automjetit. Aktivi do të nxirret jashtë përdorimit në fund të periudhës së qirasë nga kompania e cila e ka dhënë me qira. Pronësia ligjore e aktivit mbetet tek kompania qiradhënëse.

Makina do të trajtohet si një aktiv i OJF-së dhe jo i kompanisë qiradhënëse. Kjo ndodh për shkak se ekzistenca e qirasë i jep OJF-së të drejtën e përdorimit të aktivit dhe një shkallë të kontrollit mbi aktivin gjatë periudhës së qirasë. Për këtë arsye, makina do të përfshihet si një aktiv në pasqyrën financiare të OJF-së.

Ky është edhe një shembull i konceptit të “përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore”, një nga konceptet e theksuara në paragrafin 10 të standardit.

UZ 16 Pjesa tjetër e rëndësishme e përkufizimit të një aktivit është se një objekt apo një e drejtë mund të njihet si aktiv vetëm në qoftë se *përfitimet ekonomike* apo *lloje të tjera të mundshme përfitimesh* priten të hyjnë në të ardhmen në OJF-në raportuese. Përfitimet ekonomike në të ardhmen kontribuojnë në dy mënyra, përsa i përket rrjedhjes së mjeteve monetare (ose ekuivalenteve të mjeteve monetare) për këtë njësi, ose duke shtuar flukset hyrëse të parasë në OJF ose pakësuar flukset dalëse të parasë.

Përfitime të tjera të mundshme realizohen kur aktivet përdoren për të siguruar mallra apo shërbime në përputhje me objektivat e OJF-së por nuk gjenerojnë flukse monetare neto. Sa më sipër mund të krahasohet me konceptin e *'mundësisë së ofrimit të shërbimeve'* prezantuar në SNKSP¹ 17 dhe SNKSP të tjera në lidhje me aktivet e përdorura nga njësitë ekonomike jofitimprurëse në ofrimin e shërbimeve por që nuk gjenerojnë flukse monetare neto.

UZ 17 Pra, paragrafi 17 kërkon që një aktiv të njihet si i tillë vetëm nëse është e mundur të gjenerojë përfitime ekonomike në të ardhmen ose lloje tjera të mundshme të përfitimeve për njësinë ekonomike raportuese.

Shembulli 2

Një OJF zotëron një makinë me vlerë 1.000.000 lekë e cila është përdorur në të kaluarën për të prodhuar artikuj të cilët shiteshin për të grumbulluar fonde publike. Legjislacioni i ri i qeverisë parashikon që OJF-ja nuk lejohet ta përdorë më këtë aktiv dhe kjo makinë nuk ka më asnjë vlerë si skrap.

Meqënëse OJF-ja nuk është e lejuar me ligj të përdorë këtë makinë, ky aktiv nuk ka potencialin të kontribuojë në rrjedhën e parasë së njësisë ekonomike jofitimprurëse. Meqënëse makina nuk ka vlerë as si skrap, OJF-ja nuk mund të gjenerojnë të holla duke e shitur atë. Në këtë rast, kur aktivin nuk mund të gjenerojë për njësinë ekonomike raportuese përfitime ekonomike në të ardhmen apo lloje të tjera të mundshme përfitimesh, atëherë nuk mund të njihet si aktiv në pasqyrat financiare.

¹ SNKSP – Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

Shembulli 3

Një OJF drejton një ekspozitë, ku publikut i lejohet hyrja pa pagesë. Shumë nga ekspozimet e paraqitura tregojnë për publikun në lidhje me punën bamirëse të kryer nga OJF-ja.

Ekspozita mund të njihet nga OJF-ja si një aktiv meqenëse i mundëson organizatës të realizojë objektivat e saj të përgjithshme. Ekspozita siguron lloje të tjera të mundshme përfitimesh (por jo një përfitim ekonomik, pasi organizata nuk gjeneron mjete monetare përmes përdorimit të saj), dhe kështu plotëson kriteret e standardit për njohjen e një aktivi.

Një tjetër mënyrë për t'i parë "llojet e tjera të mundshme të përfitimeve" është shqyrtimi nëse organizata do të dëshironte zëvendësimin e aktivit në qoftë se ai do të humbiste apo shkatërrohej. Nëse është kështu, ky është një tregues gjenerimi përfitimesh për organizatën.

UZ 18 Kur kontrolli i një zëri është i kushtëzuar me një ngjarje që pritet të ndodhë atëherë zëri në fjalë nuk mund të njihet si aktiv pasi kontrolli duhet të kishte lindur si rrjedhojë e ngjarjeve të kaluara. Kur ekzistojnë zëra të tillë, duhet të shpjegohen në shënimet e pasqyrave financiare. Në rastet e trashëgimive, nëse shuma e lënë trashëgimi për një OJF duhet akoma të kalojë përmes një procesi formal përpara se të konfirmohet, kjo shumë nuk duhet të njihet derisa procesi të ketë përfunduar tërësisht.

UZ 19 Detyrimi përcaktohet në paragrafin 18 si “një detyrimi aktual i njësisë ekonomike raportuese (a) lindur nga ngjarje të shkuara; dhe (b) shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me flukse dalëse të përfitimeve ekonomike ose llojeve të tjera të mundshme të përfitimeve.”

UZ 20 Thelbi i këtij përkufizimi është që njësia ekonomike ka *detyrimin* të shlyejë shumën. Në shumicën e rasteve ky detyrim është një detyrim ligjor, i tillë si në rastin e një kontrate, por njohja e një detyrimi gjithashtu lejon njohjen edhe të një *detyrimi konstruktiv*. Një detyrim konstruktiv është një detyrim që rrjedh nga veprimet e një njësie ekonomike kur (a) njësia ekonomike ka treguar që ajo dëshiron të pranojë përgjegjësi të caktuara, dhe (b) njësia ekonomike ka krijuar një pritshmëri të vlefshme nga ana e palëve të tjera se ajo do t'i marrë përsipër këto përgjegjësi. Është e rëndësishme në këto raste, dallimi mes një detyrimi dhe një angazhimi në të ardhmen.

UZ 21 Një detyrim paraqet një situatë ku njësia ekonomike jofitimprurëse nuk ka asnjë mundësi reale për të shmangur marrëveshjen. Një angazhim i ardhshëm është thjesht qëllimi nga ana e njësisë ekonomike jofitimprurëse për të arritur një marrëveshje në të ardhmen, por OJF nuk është e detyruar ta bëjë këtë dhe mund ta shmangë marrëveshjen në të ardhmen nëse dëshiron.

Shembulli 4

Një OJF menaxhon një dyqan si një aktivitet tregtar për mbledhjen e fondeve dhe ka një politikë të kthimit të artikujve të shitur më tolerante se kërkesat ligjore ose kontraktuale. Ndalimi i kësaj praktike do të dëmtonte reputacionin e OJF-së dhe mundësinë për të vazhduar aktivitetin e mbledhjes së fondeve.

Në këtë rast, qëllimi për të kthyer paratë do të trajtohet si një detyrim edhe pse konsumatori nuk ka të drejtë ligjore të detyrojë OJF-në për kthimin e parave. OJF-ja duhet të vlerësojë detyrimin p.sh duke përdorur eksperiencën të kaluarë të asaj pjese të shitjeve që rezultojnë me fitim.

UZ 22 Aktivet neto janë përkufizuar në paragrafin 19 si diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve të organizatës. Për OJF-të, ekziston një dallim i rëndësishëm në kuadër të aktiveve neto mes aktiveve që janë të kufizuara dhe atyre të pakufizuara. Dallimi qëndron në faktin nëse dhuruesi i fondeve ka vënë kufizime në mënyrën e përdorimit të tyre nga ana e OJF-së.

UZ 23 Mbi fondet e dhuruara mund të vendosen kufizime në forma të ndryshme (paragrafi 20). Kufizimet mund të lidhen me fushën e veprimtarisë ku fondet duhet të përdoren, kohën e përdorimit të fondeve, etj. Në disa raste, fondet e dhuruara është e detyrueshme të investohen nga OJF-ja dhe vetëm të ardhurat e gjeneruara nga investimi lejohet të shpenzohen (*dhe natyra e shpenzimeve gjithashtu ka kufizime*). Rastet kur fondet duhen investuar dhe shumën e investimit duhet të ruhet, fondet njihen si “endowment funds” “fonde të përjetshme”. Fondet e përjetshme të klasifikuara nën aktivet neto me kufizime do të kenë ekuivalentin e tyre tek investimet në anën e aktiveve të pasqyrës financiare.

UZ 24 Është e rëndësishme që përdoruesit e pasqyrave financiare të OJF-ve të jenë në gjendje të dallojnë midis fondeve të cilat OJF-ja është e lirë për t'i përdorur në çdo mënyrë që ajo zgjedh dhe atyre që janë të kufizuara në përdorim për shkak të kufizimeve të përcaktuara nga donatorët. Në rastet kur një pjesë e madhe e aktiveve neto janë të kufizuara, pozita e OJF-së është më pak fleksibël se kur aktivet janë kryesisht të pakufizuara. Është gjithashtu e rëndësishme për përdoruesit të kuptojnë natyrën e kufizimeve të vendosura dhe se si ato ndikojnë në zërat që përbëjnë totalin e aktiveve të kufizuara. Shënimet shpjeguese duhet të japin detaje të natyrës së kufizimeve si dhe shumën e prekura nga çdo kufizim.

Shembulli 5

Një OJF-je, që operon në fushën e mirëqenies së kafshëve, i janë dhuruar disa automjete. Donatori ka përcaktuar se këto mjete duhet të përdoren për transport kur kafshët zhvendosen apo çohen tek veterineri.

Meqënëse aktivet janë subjekt i një kufizimi të vendosur nga donatori, ato do të duhet të regjistrohen në aktivet neto të kufizuara. Kjo paraqitje siguron informacion për përdoruesit e pasqyrave financiare, duke treguar shkallën e kufizimeve të aktiveve neto të organizatës dhe pjesën e atyre aktiveve që janë në dispozicion të organizatës për t'u përdorur sipas dëshirës (brenda objektivave të organizatës).

UZ 25 Aktivet neto të pakufizuara (paragrafët 21-22) krijohen nga aktivitetet e përditshme të OJF-së, mbledhja e fondeve, donacionet e përgjithshme (pa kufizime të donatorëve), etj. OJF-ja është e lirë të përdorë këto aktive në mënyrën që e shikon të arsyeshme në përmbushje të objektivave të përgjithshëm të deklaruar, ligjeve përkatëse në fuqi dhe çdo detyrimi kontraktual.

UZ 26 Ka raste kur dallimi midis aktiveve të kufizuara dhe të pakufizuara është një çështje gjykimi. Po kështu është çështje gjykimi kur një zë mund të lëvizë nga ‘i kufizuar’ në ‘i pakufizuar’ (lëvizja në drejtimin tjetër është më pak e mundur). Për shembull, mund të jetë një kufizim i cili do të hiqet sapo të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara, siç mund të jetë përmbushja e disa afateve kohore apo përfundimi i një aktiviteti. Shënimet e pasqyrave financiare duhet të sqarojnë nëse kufizimet mund të hiqen ose jo në të ardhmen dhe të japin informacion për lexuesin të cilin e ndihmon të vlerësojë nëse heqja ka shanse të zbatohet ose jo. Në rastin kur OJF përmbush kushtet e vëna nga donatori, aktivet në pasqyrat financiare mund të transferohen nga aktivet neto të kufizuara tek ato të pakufizuara. Përshkrimet e mëposhtme mund të përdoren për të treguar arsyen e transferimit tek aktivet neto të pakufizuara:

- Përmbushja e kufizimit të programit;
- Përmbushja e kufizimit për blerjen e aktivitetit;
- Përfundimi i afatit të kufizimit;

UZ 27 Paragrafi 23 përcakton të ardhurat si flukse hyrëse (rritje të përfitimeve ekonomike ose përfitimeve të tjera të mundshme) gjatë periudhës raportuese, që sjellin rritje të aktiveve ose ulje të detyrimeve. Këto flukse sjellin rritje të aktiveve neto të pakufizuara OJF-së.

UZ 28 Përkufizimi i të ardhurave ndahet në dy tipe:

1. Të ardhurat –të ardhurat që lindin gjatë veprimtarive të zakonshme të një njësie ekonomike. Këto të ardhura për qëllime të paraqitjes në pasqyrë ndahen në gjashtë lloje kryesore (paragrafi 48). Këto shuma të të ardhurave përdoren për llogaritjen e rritje / uljeve të aktiveve neto në pasqyrën e aktiviteteve.

2. Fitimet – janë zëra që plotësojnë përkufizimin e të ardhurave siç është përcaktuar në paragrafin 23 të Standardit, por nuk gjenerohen nga aktivitetet e zakonshme. Një shembull do të ishte rritja e vlerës së një investimi gjatë periudhës raportuese. Këto zëra të të ardhurave duhet të tregohen si zëra të veçantë në totalin e të ardhurave dhe fitimeve të periudhës raportuese qoftë në lidhje me rritje/uljet e aktiveve neto të pakufizuara apo rritje / uljet në aktivet neto të kufizuara.

UZ 29 Paraqitja e të ardhurave dhe fitimeve në pasqyrën e aktiviteteve mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Çdo OJF duhet të përcaktojë një politikë të tillë për paraqitjen e të ardhurave që paraqet më mirë aktivitetin e OJF-së dhe përmbush kërkesat e standardit. Në vijim është dhënë një mënyrë që përmbush kërkesat e standardit por ka dhe qasje të tjera që do të ishin të pranueshme:

| | Aktivet e pakufizuara | Aktivet e kufizuara | Total |
|---|-----------------------|----------------------|----------------------|
| | 000 lekë | 000 lekë | 000 lekë |
| <i>Të ardhurat, fitimet dhe mbështetje të tjera:</i> | | | |
| Kontributet | 8,640 | 8,110 | 16,750 |
| Tarifat | 5,400 | | 5,400 |
| Të ardhurat nga investimet afatgjata | 5,600 | 2,580 | 8,180 |
| Të ardhurat e tjera të investimeve | 850 | | 850 |
| <i>Të ardhurat totale</i> | <i>20,490</i> | <i>10,690</i> | <i>31,180</i> |
| Fitimet e perealizuara në investimet afatgjata | 8,228 | 2,952 | 11,180 |
| Të tjera | 150 | | 150 |
| Aktivet neto të çliruara nga kufizimet | 11,990 | (11,990) | 0 |
| Totali i të ardhurave, fitimeve dhe të tjera | 40,858 | 1,652 | 42,510 |

UZ 30 Njohja e aktiveve dhe të ardhurave mund të bëhet duke përdorur pemën e vendimit treguar në Aneksin 2 që shoqëron këtë udhëzues.

UZ 31 Shpenzimet janë përcaktuar në paragrafin 24 në terma të ngjashme me përcaktimin e të ardhurave, përveç se referenca është për flukset dalëse që rezultojnë në rënie të aktiveve neto të pakufizuara. Ashtu si me të ardhurat, përcaktimi i referohet të dy formave; si përfitimeve ekonomike ashtu dhe formave të tjera të përfitimeve të mundshme. Për shpenzimet ekziston gjithashtu nevoja për të bërë dallimin dhe ndarjen e flukseve dalëse gjatë periudhës në ‘shpenzimeve’ dhe ‘humbje të tjera’.

UZ 32 Në vijim është një shembull se si shpenzimet paraqiten në pasqyrën e aktiviteteteve të organizatës, por ka edhe qasje të tjera që do të quheshin të pranueshme në kuadër të kërkesave të standardit. Shpenzimet për aktivitetet e shfrytëzimit mblidhen dhe paraqiten së bashku, më pas veçmas paraqiten humbjet e tjera. Shpenzimet pakësojnë aktivet neto të pakufizuara. Humbjet mund të prekin aktivet neto të kufizuara, si në rastin kur një investimi të lidhur me një aktiv të kufizuar i ka rënë vlera gjatë periudhës raportuese, duke rezultuar kështu në një humbje.

| | Aktive të pakufizuara | Aktive të kufizuara | Totali |
|--|-----------------------|---------------------|----------------------|
| | 000 lekë | 000 lekë | 000 lekë |
| <i>Shpenzimet dhe humbjet:</i> | | | |
| Programi A | 13,100 | | 13,100 |
| Programi B | 8,540 | | 8,540 |
| Programi C | 5,760 | | 5,760 |
| Shpenzime administrimi dhe të përgjithshme | 2,420 | | 2,420 |
| Mbledhje fondesh | 2,150 | | 2,150 |
| <i>Shpenzimet total</i> | <i>31,970</i> | | <i>31,970</i> |
| | | | |
| Humbjet nga zjarri | 80 | | 80 |
| Humbja aktuariale nga obligacionet | | 30 | 30 |
| <i>Humbje të tjera total</i> | <i>80</i> | <i>30</i> | <i>110</i> |
| | | | |
| Totali shpenzimeve dhe humbjeve | 32,050 | 30 | 32,080 |

SEKSIONI II - PASQYRAT FINANCIARE TË OJF-VE

UZ 33 Paragrafët 25 dhe 26 përmbledhin pasqyrat financiare që do të përgatiten nga OJF-të. OJF-të të cilat kanë aktive ose të ardhura vjetore më të mëdha se 5 milionë lekë duhet të hartojnë të gjitha pasqyrat financiare të listuara në paragrafin 25 dhe të aplikojnë kontabilitetin rritës; Megjithatë OJF-të që janë më poshtë se ky prag mund të zbatojnë kontabilitetin monetar dhe duhet të hartojnë vetëm pasqyrën e thjeshtuar të fluksit të mjeteve monetare. Në të dyja rastet OJF-së i kërkohet të përgatisë shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në mënyrë që përdoruesit të kuptojnë llojet e aktiviteteve dhe shërbimeve në të cilat është përfshirë njësia ekonomike jofitimprurëse.

Shembulli 6

Për të ndihmuar donatorët, kreditorët dhe të tjerë që të vlerësojnë aktivitetet e organizatës, përfshirë koston e shërbimeve dhe se si përdoren burimet, shënimet e pasqyrave duhet të sigurojnë informacion mbi shpenzimet të raportuara në bazë të klasifikimit sipas funksionit (në klasa të ndara, shërbime parësore të programit dhe shërbime mbështetëse) dhe sipas klasifikimit ekonomik (siç janë pagat, qiraja, energjia, etj) në qoftë se ky lloj informacioni nuk jepet i detajuar në pasqyrat financiare.

Shpenzime të programit janë ato të cilat sigurojnë mallra apo shërbime për t'ju shpërndarë përfituesve, klientëve apo anëtarëve me qëllim plotësimin e misionit të ekzistencës së organizatës. Për shembull, universitetet kanë, ndër të tjera, programe për udhëzimin e studentëve, për punë kërkimore apo për publikime.

Aktivitete mbështetëse janë të gjitha ato aktivitete që nuk përfshihen në aktivitetet e programit. Këto aktivitete përfshijnë menaxhimin, administrimin, mbledhjen e fondeve dhe aktivitetet për mbajtjen dhe rritjen e anëtarësisë.

Shembulli kompleks në aneksin 1 të këtij udhëzuesi përfshin një shembull të pasqyrës së aktiviteteve. Zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve kryesisht janë paraqitur duke përdorur klasifikimin ekonomik, duke i grupuar zërat sipas natyrës (kontribute, grante, etj). Megjithatë në seksionin e shpenzimeve ka dy zëra që reflektojnë programet e OJF-së: p.sh, “orët e klasave të terapisë” dhe “ekspozitat”.

UZ 34 Shënimet e pasqyrave financiare duhet të japin informacion të mjaftueshëm për përdoruesit që ata të kuptojnë natyrën e shumave brenda pasqyrave financiare. Kjo përfshin detaje të mëtejshme mbi marrëveshjet e detyrimeve (p.sh. marrëveshjet në lidhje me kreditë, si p.sh. periudha e mbetur, interesi i aplikueshëm, çfarëdo sigurimi mbi pasuritë, etj). Shënimet mund të japin gjithashtu informacion mbi llojet ose kufizimet e aplikuar mbi këto aktive si dhe nëse këto kufizime janë të përkohshëm ose të përhershëm. Kriteri kryesor që duhet të zbatohet në përcaktimin nëse një shënim shtesë është i nevojshëm apo jo, është të pyesësh nëse përdoruesit kanë informacion të mjaftueshëm nga pasqyrat financiare për të vlerësuar pozitën financiare dhe performancën financiare dhe së fundmi për të marrë vendime. Nëse përgjigja është se ata nuk e kanë aq informacion, atëherë duhet të shtohet një shënim shtesë që të ofrojë informacionin e nevojshëm për përdoruesit.

UZ 35 Lloji i informacionit që zakonisht kërkohet nga përdoruesit, përshkruhet në paragrafët 27 deri në 28 dhe mbulon tri fusha kryesore:

a) *Shërbimet që OJF-ja ofron dhe mundësia për të siguruar vazhdimësi në këto shërbime.* Kjo duhet të jetë e qartë nga lista e programeve të shpenzimeve që përfshihen në pasqyrën e aktiviteteve dhe nga shënimet e pasqyrave që përshkruajnë apo detajojnë aktivitetet në të cilat OJF-ja është angazhuar. Kjo është e lidhur me përgjegjshmërinë financiare - dmth që OJF-ja po i përdor burimet për aktivitete për të cilat është themeluar.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-së duhet të zbatohet parimi i vijimësisë. Pasqyrat financiare do të përgatiten me pritshmërinë se OJF-ja do të vazhdojë të kryejë aktivitete të ngjashme edhe në të ardhmen dhe është financiarisht në gjendje për ta bërë këtë. Çdo shqetësim në këtë drejtim duhet të bëhet i qartë.

Shembulli 7

Një OJF ka përgatitur pasqyrat e saj financiare dhe ka raportuar një rritje të të ardhurave mbi shpenzimet gjatë periudhës si dhe ka një sasi të vogël të hollash gjendje. Gjatë tre viteve të fundit, më shumë se 50% e të ardhurave të saj kanë ardhur nga një donator i vetëm dhe ka tregues se donatori nuk do të vazhdojë të mbështesë më llojin e aktivitetit të zhvilluar nga OJF-ja në fjalë.

Do të ishte çorientuese për përdoruesit e pasqyrave nëse OJF-ja nuk nxjerr në pah në shënimet shpjeguese (*shënimet kanë referencat përkatëse të zërave në pasqyrë*) që ky burim kryesor i të ardhurave është i pasigurtë në të ardhmen. Mund të ngrihen pikëpyetje mbi vijimësinë e OJF-së, përveç rastit kur kjo e fundit e ka të mundshme të identifikojë një burim të ardhurash alternativ për të zëvendësuar atë që do përfundojë, ose t'i përshtasë aktivitetet e saj të ardhshme sipas nivelit të reduktuar të të ardhurave.

b) *Si menaxherët përmbushin përgjegjësitë e tyre të administrimit dhe bashkëpunojnë me të tjerët.* Menaxhimi mbulon një sërë aktivitetesh ndër të cilat edhe ruajtja e aktiveve të organizatës. Performancën e realizimit të kësaj përgjegjësie përdoruesit mund ta vlerësojnë përmes treguesve në pasqyrat financiare (zhvlerësimi, amortizimi, vlera e mbetur e AAM-ve dhe AAJM-ve, etj) si dhe nga shënime të hollësishme mbi pronën, makineritë dhe pajisjet.

c) *Aspekte të tjera të performancës së OJF-ve.* Kjo është një çështje gjithëpërfshirëse dhe në thelb i ngarkon OJF-së përgjegjësinë për identifikimin e asaj që një përdorues kërkon të dijë dhe jo standardit. Për arsye se OJF-të mbulojnë një gamë të gjerë aktivitetesh, sektorësh, madhësish, pozicionesh gjeografike, etj, është e rëndësishme për çdo OJF të përcaktojë se kush janë përdoruesit e pasqyrave të tyre financiare dhe cilat mund të jenë nevojat e tyre, specifike apo të përgjithshme.

UZ 36 Një nga qëllimet e përmendura në paragrafin 28 është të mundësohet informacion mbi "përpjekjet për shërbime nga organizata". Kjo mund të arrihet kryesisht duke i'u referuar programeve të ndryshme të OJF-së në pasqyrën e aktiviteteve dhe shënimeve të lidhura me to. Kjo shpjegohet më tej në paragrafët 58 deri 64.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

UZ 37 Paragrafët 29-30 përmbledhin qëllimin e pasqyrës së pozicionit financiar, duke përfshirë faktin se ajo duhet të japë informacion mbi aktivet, detyrimet dhe aktivet neto të njësisë ekonomike.

UZ 38 Niveli i detajeve dhe mënyra në të cilën zërat janë paraqitur veçmas ose të grupuara së bashku është diskutuar në paragrafët 31 deri 35. Një nga ndikimet në përcaktimin e paraqitjes është edhe koncepti i materialitetit. Standardi nuk i referohet kësaj çështje në mënyrë direkte, por udhëzon që pasqyra duhet të japë informacion që bashkon aktivet / detyrimet, që kanë karakteristika të ngjashme, në grupime të arsyeshme homogjene. Pra, një aktiv / detyrim me vlerë të vogël mund të grupohet me aktive / detyrime të tjera, me kusht që rezultati të jetë një "grup me homogjenitet të arsyeshëm". Për përcaktimin e grupeve homogjene kërkohet gjykim profesional si ilustrohet në shembullin 8 më poshtë.

Shembulli 8

Një OJF ka në llogaritë e saj të investimit tepricat si vijon:

| | |
|-----------------------------|------------|
| <i>Investime A (5 vjet)</i> | <i>500</i> |
| <i>Investime B (5 vjet)</i> | <i>50</i> |
| <i>Investime C (3 muaj)</i> | <i>20</i> |

Do të ishte e pranueshme për OJF-në që të bashkojë dy shumat e investimeve A dhe B dhe të tregojë një aktiv – ‘investim afatgjatë’ prej 550. Nuk gjykohet e përshtatshme të përfshihet investimi C në këtë total, sepse është e qartë që nuk është një investim afatgjatë. Investimi C duhet të tregohet veçmas nën aktivet aktuale si një investim afat-shkurtër. Megjithëse influenca e investimit C në pasqyrën e pozicionit financiar është në masë të vogël dhe ndoshta mund të konsiderohet si jo-material që nuk kërkon dhënie të informacioneve shpjeguese të veçanta, natyra e këtij aktivi afatshkurtër sugjeron që duhet të mbahet veç nga dy investimet e tjera A, B.

UZ 39 Paragrafi 33 i referohet një shembulli tjetër në të cilin natyra e një aktivi kërkon që ai të jetë i paraqitur veçmas në pasqyrë edhe pse mund të duket se ka karakteristika të ngjashme me aktivet e tjera. Kur një donator ka vendosur kufizime mbi një shumë mjetesh monetare apo aktive të caktuara, ato duhet të mbahen veç nga mjetet monetare ose aktivet e tjera që nuk janë të kufizuara. Kjo do të thotë që një përdorues jo vetëm e di se sa janë burimet totale të OJF-së në datën e raportimit, por gjithashtu e di dhe se sa nga ky total janë në dispozicion për përdorim aktual dhe se sa mund të përdoren nën kufizimet strikte të vendosura nga donatorët.

UZ 40 Paragrafët 36 deri 39 trajtojnë një nga dallimet më të rëndësishme në kuadër të standardit: d.m.th dallimin midis aktiveve neto të kufizuara dhe atyre të pakufizuara. Ky dallim nuk është thjesht një nga paraqitjet formale. Të kuptuarit saktë i pozitës financiare të OJF-së është e një rëndësie themelore. Të marra së bashku, vlera totale e aktiveve neto jep disa informacione të rëndësishme mbi pozitën financiare të organizatës. Megjithatë, vetëm duke parë se sa prej këtyre aktiveve janë të kufizuara dhe se sa janë në dispozicion për nevoja të përgjithshme, përdoruesi mund të arrijë të gjykojë konkretisht pozicionin financiar. Përveç kësaj, shënimet shpjeguese të

pasqyrave duhet të japin informacion mbi natyrën e kufizimeve që janë vendosur, në mënyrë që të vlerësohet se si këto ndikojnë në pozicionin financiar të organizatës.

UZ 41 Mënyra se si aktivet neto të kufizuara do të analizohen varet nga organizata dhe lloji i kufizimeve të vendosura nga donatorët. Është e lejueshme të grupohen lloje të ndryshme aktivesh neto të kufizuara, brenda pasqyrës së pozicionit, me kusht që ato të krijojnë një grup me homogjenitet të arsyeshëm. Për shembull, të gjitha aktivet neto të kufizuara, që janë për t'u përdorur në një projekt specifik ndërtimi, mund të paraqiten si zëra të një rreshti në pasqyrën e pozicionit financiar edhe në qoftë se ato janë siguruar nga donatorë të ndryshëm.

UZ 42 Varet nga gjykimi i vetë drejtimit të OJF-së nëse zgjedh të analizojë aktivet neto të kufizuara në zëra të veçantë brenda në pasqyrën financiare apo t'i paraqesë detajet si shënime në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Çështjet e materialitetit dhe qëndrueshmërisë duhet të drejtojnë OJF-në në gjetjen e qasjes më të përshtatshme për organizatën dhe për nevojat e përdoruesve të tyre.

Shembulli 9

Një OJF ka aktive neto të kufizuara në vlerën 5.2 milionë. Prej tyre, 2 milion janë fonde të marra për blerjen e një skaneri mjekësor me vlerë të drejtë prej 3.5 milion. Fondet e siguruar deri më sot konsistojnë në një donacion të vetëm 800,000 nga një biznesmen lokal, i cili kërkon që paratë të përdoren deri në fund të vitit të ardhshëm financiar dhe pjesa tjetër ka ardhur nga aktivitetet lokale për mbledhjen e fondeve.

OJF-ja ka vendosur të paraqesë në pasqyrën e pozicionit financiar fondet që lidhen me këtë projekt veç e veç, si më poshtë:

Aktivitet neto të kufizuara:

| | |
|-----------------------------------|-----------|
| - Projekti për blerjen e skanerit | 2,000,000 |
| - Të tjera | 3,200,000 |
| Totali | 5,200,000 |

Një shënim në pasqyrën financiare gjithashtu thekson se 800,000 të caktuara nga projekti për blerjen e skanerit mjekësor duhet të shpenzohen deri në fund të vitit të ardhshëm financiar.

UZ 43 OJF-të duhet gjithashtu të gjykojnë për të përcaktuar nëse aktivet neto të pakufizuara duhet të analizohen apo të paraqiten në një rresht të vetëm. Paragrafi 39 tregon se kur ka një vendim të marrë nga vetë OJF-ja për përdorimin e fondeve, do të ishte e përshtatshme që kjo shumë të tregohet më vehte, brenda kategorisë së aktiveve neto të pakufizuara. Detajet mbi natyrën e vendimit, marrë nga OJF-ja, duhet të jepen në shënimet e pasqyrave financiare. Aty duhet të theksohet se çdo vendim i marrë nga vetë organizata për kufizimin e përdorimit të ndonjë fondi të veçantë nuk do të thotë që këto fonde duhet të përfshihen në aktivet neto të kufizuara; standardi bën të qartë se aktivet neto të kufizuara duhet të përfshijnë vetëm ato shuma mbi të cilat janë vendosur kufizimet e donatorëve.

PASQYRA E AKTIVITETEVE

UZ 44 Paragrafët 40 deri në 43 japin informacion mbi natyrën dhe qëllimin e pasqyrës së aktiviteve, e cila ka një funksion të ngjashëm me pasqyrën e të ardhurave ose pasqyrën e performancës financiare të hartuar nga njësitë e tjera fitimprurëse. Megjithatë, në vend të fitimit ose humbjes, pasqyra e aktiviteve përdor në pasqyrë termin *ndryshimi në aktivet neto* si diferencë ndërmjet të ‘ardhurave’ / ‘fitimeve’ dhe ‘shpenzimeve’ / ‘humbjeve të tjera’.

UZ 45 Edhe pse paragrafi 43 deklaron që pasqyra e aktiviteve duhet të fokusohet në njësinë si një e tërë, është e qartë nga paragrafët 44-46, që është e përshtatshme që organizata të japë informacione shpjeguese për aktivet neto të kufizuara dhe të pakufizuara. Ndryshimi në aktivet neto duhet të jetë i ndarë në: (1) ndryshimin në aktivet neto të kufizuara dhe (2) ndryshimin në aktivet neto të pakufizuara.

Një shembull se si mund të paraqitet kjo, jepet më poshtë:

| | Aktivete neto të pakufizuara | Aktivete neto të kufizuara | Totali |
|---|-------------------------------------|-----------------------------------|----------------|
| | <i>000 lek</i> | <i>000 lek</i> | <i>000 lek</i> |
| Totali i të ardhurave, fitimeve dhe të tjera | 40,858 | 1,652 | 42,510 |
| Totali shpenzimeve dhe humbjeve | 32,050 | 30 | 32,080 |
| Ndryshimi në aktive neto | 8,808 | 1,622 | 10,430 |
| Aktive neto në fillim të vitit | 103,670 | 25,470 | 129,140 |
| <i>Aktive neto në fund të vitit²</i> | <i>112,478</i> | <i>27,092</i> | <i>139,570</i> |

Paraqitja e pasqyrave financiare në këtë mënyrë plotëson kërkesat e paragrafit 43 të Standardit, sipas të cilit “*Ndryshimi në aktivet neto i paraqitur në pasqyrën e aktiviteve duhet të artikulohet në aktivet neto të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar*”, meqenëse çelja dhe mbyllja e aktiveve neto përputhen me ndryshimin në aktivet neto të raportuar në pasqyrën e aktiviteve. Një shembull më i plotë i kësaj paraqitjeje jepet në Aneksin 1 – Shembull gjithëpërfshirës.

UZ 46 Paragrafët 47-49 japin më të detajuar se si të ardhurat dhe shpenzimet përcaktohen dhe paraqiten në pasqyrën e aktiviteve, duke ndjekur paragrafët 23-24 ku jepen përkufizimet e tyre.

UZ 47 Në paragrafin 50 trajtohet ajo që është përmendur si një aktivitet tregtar. Një shembull do të jetë një muzeum që nuk ka tarifë për hyrje në mjediset e tij, por ka një dyqan dhuratash, si pjesë e veprimtarisë së tij. Dyqani i dhuratave është një aktivitet tregtar i ngritur për të gjeneruar të ardhura neto (ose fitim). Prandaj, është e arsyeshme që të zbatohet parimet e raportimit financiar për aktivitetet fitimprurëse. Kërkesat e këtij paragrafi mund të plotësohen duke përgatitur një pasqyrë të veçantë të të ardhurave për veprimtarinë tregtare dhe duke përfshirë shumën neto (të ardhurat neto / fitim apo kosto neto / humbje) si një zë brenda pasqyrës së aktiviteve. Pasqyra e plotë e të ardhurave për dyqanin e dhuratave duhet të përfshihet tek shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të OJF-së.

UZ 48 Paragrafët 51 deri në 53 diskutojnë trajtimin e kontributeve, si të ardhura të pakufizuara apo të kufizuara, në varësi të faktit nëse ka kufizime të donatorëve apo jo. Shembujt e pasqyrës së

² Këto shuma do të tregohen nën aktivet neto në pasqyrën e pozicionit

aktiviteteve më lart tregojnë se si këto kontribute janë paraqitur në kolonat përkatëse brenda pasqyrës.

UZ 49 Është e rëndësishme për çdo OJF, që të ketë politika të cilat trajtojnë rastet kur kufizimet e donatorëve plotësohen gjatë periudhës së raportimit. Me plotësimin e termave të donatorëve, kufizimi mbi kontributet nuk do të zbatohet më, kështu që shuma mund të tregohet brenda aktiveve neto të pakufizuara. Ky trajtim duhet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha kontributet e marra në atë periudhë.

Shembull 10

Një OJF ka marrë kontribute nga një donator gjatë një periudhe dy vjeçare. Në vitin e parë, ka marrë 500.000 lekë në katër këste tremujore. Në vitin e dytë, ka marrë 600.000 lekë në katër këste tremujore.

Donatori ka përcaktuar se fondet mund të përdoren vetëm për të mbështetur aktivitetet mjedisore në rajonin veri-lindje të vendit. OJF-ja u angazhua gjatë vitit të parë në përgatitjen e aktiviteteve të tilla dhe këto aktivitete filluan në tremujorin e 3-të të vitit të dytë. Të gjitha fondet janë përdorur në fund të vitit të dytë.

Në vitin e parë, është e qartë se OJF-ja duhet t'i raportojë kontributet si të ardhura të kufizuara dhe si një rritje në aktivet neto të kufizuara. Aktiviteti nuk kishte filluar gjatë vitit të parë, pra kufizimi i donatorëve egziston.

Në vitin e dytë, disa nga kontributet janë marrë para se kufizimet e donatorëve të ishin përmbushur. Megjithatë, deri në fund të periudhës raportuese kufizimet ishin plotësuar. Pra është e përshtatshme që gjatë gjithë vitit të dytë, kontributet të tregohen si të ardhura të pakufizuara, sepse në datën e raportimit kufizimet janë përmbushur.

Gjithashtu, në pasqyrën e aktiviteteve në vitin e dytë duhet të tregohet transferimi i 500.000 lekëve nga aktivet e kufizuara në aktivet e pakufizuara, për të dhënë qartë informacionin se shumatat e marra në vitin e mëparshëm u bënë të vlefshme për përdorim.

UZ 50 Në të gjithë standardin, aplikohet parimi i “paraqitjes për bruto” për të gjitha transaksionet si të ardhurat, shpenzimet, aktivet, detyrimet, apo aktiveve neto të cilat pasqyrohen më vete, përveç disa zërave të lidhur me të ardhurat / shpenzimet ose aktivet / detyrimet që tregohen për vlerën neto.

Paragrafët 55 deri 57 nxjerrin në pah dy situata ku parimi i “paraqitjes për bruto” mund të zbutet dhe ku kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve mund të lejohet. Dy situatat janë:

- a) të ardhurat dhe shpenzimet nga/për investimet, dhe
- b) të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivitetet 'periferike' ose 'rastësore'.

Nuk ka asnjë përkufizim në standard për aktivitetet “periferike” apo “të rastësishme”, por është dhënë një shembull për një OJF që ka shitur tokë dhe ndërtesa që nuk i duhen më për realizimin e aktiviteteve të veta. OJF-të duhet të shqyrtojnë nëse, në kontekstin e asaj që konsiderohet si aktivitet dhe operacion normal, një transaksion mund të konsiderohet të jetë periferik apo i rastësishëm.

Kjo kërkon gjykim, duke marrë parasysh natyrën e transaksionit në kontekstin e aktiviteteve normale të OJF-së, nevojat e përdoruesve të pasqyrave financiare për informacion të rëndësishëm dhe të dobishëm dhe sa më sipër mbahet parasysh në dhënien e informacionit shpjegues.

UZ 51 Paragrafët 58 deri 64 shtjellojnë në mënyrë më të zgjeruar kërkesat për të siguruar informacion mbi shërbimet e organizatës, të cilat janë përmendur në paragrafin 28. Dallimi mes klasifikimit funksional dhe klasifikimit sipas natyrës të zërave të shpenzimeve është shumë i rëndësishëm.

Klasifikimi sipas funksionit kërkohet nga të gjitha OJF-të, që do të thotë se ato duhet të japin informacion mbi kostot e shërbimeve në aspektin e klasave kryesore të programit të shërbimeve. OJF-të gjithashtu janë të lira të japin informacion shtesë duke përdorur një klasifikim sipas natyrës (p.sh pagat, kostot e transportit, etj) në një pasqyrë të veçantë ose në shënimet shpjeguese.

Paragrafi 59, megjithatë, e bën të detyrueshme për OJF-të që janë organizata të shëndetit dhe mirëqënies të japin informacion sipas klasifikimit funksional dhe sipas natyrës, brenda të njëjtës pasqyrë ose në pasqyra të veçanta.

UZ 52 Paragrafët 60-64 përcaktojnë dhe shpjegojnë llojet e ndryshme të aktiviteteve që duhet të identifikohen veçmas në seksionin e shpenzimeve të pasqyrës së aktiviteteve. Çdo OJF duhet të marrë në konsideratë këto përshkrime me qëllim që të përcaktojë se cila kategori duhet të tregohet në secilën nga shpenzimet e tyre dhe pasi të përcaktohet kjo, OJF-ja duhet ta zbatojë këtë qasje vazhdimisht nga viti në vit.

Emërtimet që do të përdoren janë:

- Programet e shërbimeve;
- Aktivitetet mbështetëse;
- Aktivitetet e menaxhimit dhe të përgjithshme;
- Aktivitetet për mbledhjen e fondeve;
- Aktivitetet lidhur me zhvillimin e anëtarësisë;

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

UZ 53 Seksioni i standardit që ka të bëjë me pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare është shumë i shkurtër, katër paragrafë të shkurtër nga paragrafi 65 deri tek 68.

UZ 54 Format i përgjithshëm i pasqyrës është i njëjtë me atë të njësive ekonomike fitimprurëse; aktivitetet e shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe aktivitetet financuese.

UZ 55 Paragrafët 66 dhe 67 theksojnë transaksionet që kërkojnë udhëzime specifike. Të dy paragrafët kanë të bëjnë me kontribute të kufizuara, të cilat nuk duhet të përfshihen në aktivitetet e shfrytëzimit.

UZ 56 OJF-të mund të zgjedhin përdorimin e metodës direkte ose indirekte në paraqitjen e fluksit të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit. Metoda direkte do të jetë më e lehtë për t'u

aplikuar për OJF-të që përdorin kontabilitetin dhe raportimin financiar mbi baza monetare (shiko paragrafët 25-26), pasi është një rast më i thjeshtë i të gjitha hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare.

Metoda indirekte përfshin rregullime të ndryshimeve në aktivet neto të periudhës (pasqyra e aktiviteteve) për zërat jomonetarë (p.sh, ndryshimet e amortizimit) dhe ndonjë zë që duhet të tregohet në aktivitetet investuese dhe ato të financimit. Metoda indirekte është më komplekse se metoda direkte dhe prandaj inkurajohet nga standardi, që shumica e OJF-ve të zgjedhin metodën direkte si qasjen e tyre të preferuar.

SEKSIONI III

KONTRIBUTET NË KOLEKSIONE

UZ 57 Seksionet I dhe II të standardit kanë trajtuar në përgjithësi kontabilitetin për kontributet e marra nga OJF-të, duke përfshirë dallimin midis atyre që janë të kufizuara dhe atyre që janë të pakufizuara dhe se si ato paraqiten në pasqyrat financiare të OJF-së. Seksioni III jep kërkesa më të detajuara në lidhje me llojet e ndryshme të kontributeve dhe si këto duhet të trajtohen dhe të paraqiten në pasqyra.

UZ 58 Qëllimi i përcaktuar në paragrafët 70-71 jep informacion mbi atë që nënkuptohet me kontribute në këtë kontekst. Pika kryesore është se përjashtohen transfertat e mallrave ose shërbimeve kur për to ka një pagesë në vlerë të barabartë. Fokusi është kryesisht në donacionet e marra, ku OJF-së nuk i kërkohet të transferojë mallra ose shërbime te donatori. Qëllimi gjithashtu përfshin transferimin e aktiveve tek ose nga OJF-të, ku çdo pagesë ose transferim në drejtimin e kundërt është dukshëm më i vogël se vlera e aktiveve. Gjithashtu përfshin premtimet për të dhënë mjete monetare ose aktive të tjera, me kusht që të ketë evidencë të mjaftueshme se premtimi është i pakushtëzuar dhe është ligjërisht i zbatueshëm.

UZ 59 Paragrafët 74 dhe 75 japin përcaktimin e termave “kushte” dhe “kufizime”. Një kusht i vendosur nga donatori i referohet një ngjarjeje që duhet të ndodhë në të ardhmen, pasi në të kundërt OJF duhet të kthejë mbrapsht donacionin. *P.sh, një aktiv duhet ndërtuar brenda një afati të caktuar përndryshe fondet duhet të kthehen.*

Një kufizim ka të bëjë me përdorimin e fondeve. Kufizimi mund të lidhet me llojin e shpenzimit, vendndodhjen gjeografike, kohën e shpenzimit, etj. *P.sh, fondet mund të kufizohen për marrjen në punë të një stafi të caktuar për një periudhë të caktuar.*

UZ 60 Paragrafi 76 i referohet matjes së kontributeve të marra. Në rastin e kontributeve në mjete monetare, matja do të jetë shuma e parave. Në rastin e aktiveve të tjera, matja duhet të bazohet në vlerën e drejtë të tyre. Në shumë raste, vlera e drejtë do të përcaktohet duke i'u referuar çmimit të zakonshëm të tregut për aktivin ose një ekuivalenti të ngjashëm. Kur nuk ka treg të përcaktuar për një aktiv, mund të përdoret një matje e pjesshme, siç është kostoja e zëvendësimit të amortizimit për një ndërtesë.

UZ 61 Kontributet mund të pranohen edhe në formën e shërbimeve, kjo shpjegohet në paragrafët 77 deri në 80. Dy situatat ku këto kontribute mund të njihen janë a) nëse krijojnë ose përmirësojnë një aktiv jofinanciar ose b) kur kërkohen aftësi të specializuara.

Shembulli i mëposhtëm ilustron situatën (b):

Shembull 11

Një organizatë bamirëse që mbështet të pastrehët ka marrë kontribute në shërbimet e mëposhtme. Një vullnetar ka ofruar të kryejë detyra të administratës ligjore për të ndihmuar në drejtimin e përgjithshëm të organizatës së bamirësisë. Kostoja e punësimit të një avokati për të përfunduar këtë punë do të ishte 110,000 lekë.

Vlera e drejtë e kohës vullnetare është kostoja e punësimit të dikujt për të kryer detyrën, p.sh. 110,000 lekë. Kjo do të njihet si një donacion i pakufizuar dhe si një shpenzim i pakufizuar (për të siguruar parimet e regjistrimit të dyfishtë). Ndikimi neto në ndryshimin e aktiveve neto gjatë periudhës është zero por të ardhurat dhe shpenzimet totale në pasqyrën e aktiviteteve do të jenë një pasqyrim më i saktë i kostos së vërtetë të ofrimit të shërbimeve.

UZ 62 Paragrafët 81 deri 83 merren me çështjen e kontabilitetit të kontributeve në koleksione. Kjo i referohet pranimit të aktiveve që i shtohen koleksioneve të tilla si vepra arti në një galeri ose muze.

UZ 63 Zakonisht, kontabiliteti i koleksioneve të mbledhura është i njëjtë me kontabilitetin e çdo kontributi tjetër në formë jomonetare. Megjithatë një OJF-je nuk i kërkohet të njohë koleksione të tilla kur përmbushen kriteret e përcaktuara në paragrafin 81. Kjo do të thotë që, për shembull, një muze që ka një koleksion të përhershëm që është i hapur për publikun, nuk është nevoja të vlerësojë të gjithë zërat e koleksioneve të ekspozuar dhe t'i përfshijë në shumën e aktiveve të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

UZ 64 Për koleksionet që nuk i plotësojnë kriteret e parashtruara në paragrafin 81, OJF-së i kërkohet të kapitalizojë aktivet e saj. Nuk është e nevojshme për ta bërë këtë për koleksionet që ishin para datës së hyrjes në fuqi të standardit (në mënyrë retrospektive), megjithëse standardi i lejon OJF-të t'i përfshijë këto aktive nëse dëshirojnë, me kusht që kjo të bëhet në mënyrë të qëndrueshme (shiko paragrafin 82). Kontributet e aktiveve të siguruar pas hyrjes në fuqi të standardit duhet të kapitalizohen (mbi baza prospektive).

UZ 65 Paragrafi 83 kërkon që OJF-të që nuk kapitalizojnë kontributet në koleksione të japin informacione shtesë në pasqyrat financiare. Paragrafët 97-100 përmbledhin aspektet kryesore të informacionit shtesë që kërkohet:

- Koston e zërave të koleksioneve të blerë si një rënie në aktivet neto;
- Të ardhurat nga shitja e zërave të koleksioneve si një rritje në aktivet neto;
- Të ardhurat nga rimbursimi i siguracioneve të zërave të koleksionit, të humbura ose të shkatërruara, si një rritje në aktivet neto;
- Përshkrimi i koleksioneve, rëndësia e tyre dhe politikat e kontabilitetit dhe të administrimit në shënimet e pasqyrave financiare;
- Përshkrimi dhe vlera e çdo zëri të hequr nga koleksioni.

UZ 66 Të njëjtat të dhëna të listuara më sipër do të ishin të përshtatshme për një OJF që kapitalizon koleksionet e saj në mënyrë prospektive, me përjashtim të faktit që duhet të jepen shënime shpjeguese për koston e blerjes së zërave të kontributit si një rënie në aktivet neto (ose më mirë, kjo kosto do të jepet në shënimet shpjeguese si një rritje në aktivet afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar).

UZ 67 Pritet që në kushte normale një OJF me koleksione të shumta, me vlera të mëdha apo me rëndësi të madhe historike, të kapitalizojë vlerën e këtyre koleksioneve nëse plotësohen kriteret e paragrafit 81. Në këto raste vlera që i caktohet koleksioneve, nëse nuk ka evidenca të tjera, mund të jetë vlera referuese e përdorur për siguracionin e këtyre koleksioneve.

UZ 68 Kur koleksionet kanë një vlerë më të vogël apo një rëndësi më të vogël sesa në kushte normale, pritet që OJF të mos e kapitalizojë vlerën e koleksioneve në mënyrë retrospektive pasi kostot që lidhen me vlerësimin e koleksioneve ka të ngjarë të tejkalojnë përfitimet.

UZ 69 Paragrafët 84 deri në 87 merren me raportimin e kontributeve si të kufizuara ose të pakufizuara. Në disa raste, kjo është e drejtpërdrejtë. Kur ekzistojnë kufizime të qarta të vendosura nga donatorët, atëherë kontributi duhet të raportohet brenda aktiveve të kufizuara. Kur kufizimet e vendosura nga donatorët janë përmbushur gjatë periudhës raportuese, kontributet mund të raportohen si aktive të pakufizuara.

UZ 70 Premtimet e pakushtëzuara për t'u marrë nga OJF-ja në periudhat e ardhshme përgjithësisht duhet të raportohen si aktive të kufizuara.

UZ 71 Dhuratat në formën e aktiveve afatgjata materiale të marra pa kufizim për përdorimin e tyre duhet të raportohen përgjithësisht si aktive të pakufizuara, përveç rasteve kur politika kontabël e OJF-së për këto aktive parashikon që jeta e aktiveve, të jetë më e madhe se jeta aktuale e dobishme e aktivitetit.

UZ 72 Paragrafi 88 njeh që kufizimet e vendosura nga donatorët mund të përmbushen në një moment kohor, në këtë rast kontributi i lidhur nuk duhet të trajtohet si i kufizuar. Është e rëndësishme që OJF të sigurohet dhe të mos ketë dyshime se kufizimi është plotësuar. Standardi jep shembullin e ndodhjes së një shpenzimi, në këtë rast është thelbësore të garantohet, që shpenzimet kanë ndodhur në lidhje me përmbushjen e kushteve të kufizimit të vendosur nga donatorët dhe jo për ndonjë arsye tjetër, përpara riklasifikimit të kontributit si i pakufizuar.

UZ 73 Në ngjashmëri me mënyrën në të cilën trajtohen kontributet e marra, paragrafi 89 përshkruan shkurtimisht se si duhet të trajtohen kontributet e dhëna nga një OJF. Kjo është përgjithësisht një situatë e rrallë krahasuar me kontributet e marra. Trajtimi kontabël është njohja e një shpenzimi me vlerën e drejtë të aktiveve të transferuara.

Shembulli 12

Një OJF i ka dhënë borxh 10.000 lekë një organizate bamirëse që vepron në një fushë të ngjashme dhe që aktualisht po kalon vështirësi financiare. OJF-ja ka vendosur të anullojë shumën e borxhit dhe gjithashtu të dhurojë një sasi inventari me një vlerë të drejtë prej 25.000 lekë si bamirësi.

Sa më sipër do të trajtohet në llogaritë e OJF-së nga njëra anë si një shpenzim prej 35.000 lekë gjatë periudhës dhe nga ana tjetër si një pakësim prej 10.000 lekë në llogaritë e arkëtueshme dhe një pakësim prej 25,000 lekë në vlerën e inventarit.

UZ 74 Baza e matjes së vlerës së drejtë është përmendur gjatë standardit dhe përcaktimi i vlerës së drejtë është përshkruar në paragrafët 90-91. Këtu përmenden metoda të ndryshme, në varësi të informacionit që është në dispozicion të organizatës dhe natyrës së aktivitetit. Metodat janë:

- Çmimet e kuotuarra të tregut për aktivin;
- Çmimet e kuotuarra të tregut për aktive të ngjashme;
- Çmuarje të pavarura;
- Teknika të vlerësimit - p.sh. vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare.

UZ 75 Metoda për përcaktimin e vlerës së drejtë do të vendoset duke marrë parasysh informacionin në dispozicion, koston e zbatimit të metodës, përfitimin nga marrja e informacionit të mëtejshëm (siç është një vlerësim i pavarur) dhe natyrën e aktivitetit.

Për shembull, mund të jetë e justifikueshme që të përdoren shërbimet e një vlerësuesi të pavarur për të ndihmuar në vlerësimin e një veprë të rrallë të artit, ndërsa vlera e drejtë e një automjeti mund të përcaktohet zakonisht duke i'u referuar revistave tregtare të mjeteve motorrike ose faqeve të internetit. Teknika e vlerës aktuale do të ishte e përshtatshme vetëm për aktivet që përdoren specifikisht për të gjeneruar një hyrje të konsiderueshme të mjeteve monetare gjatë një periudhe të zgjatur.

UZ 76 Premtimet për t'u marrë diskutohen në paragrafët 92-96. Këto janë të ndara në premtime të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara për t'u dhënë. Kjo e fundit i referohet situatave kur duhet të ndodhë në të ardhmen një ngjarje e caktuar dhe e pasigurtë.

Shembull 13

Një OJF po mbledh fonde për të rinovuar objektet e saj. Duhet të mbledhë 2 milionë lekë për të qenë në gjendje të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me kompaninë e ndërtimit. Gjatë vitit, ajo ka mbledhur 1 milion lekë në mjete monetare dhe ka marrë angazhime të nënshkruara nga anëtarët e saj me vlerë gjithsej 900.000 lekë. OJF pret të tejkalojë objektivin prej 2 milionë lekë brenda tre muajve të parë të vitit të ardhshëm financiar. Nëse shifra e synuar nuk arrihet, anëtarët që kanë nënshkruar për të ofruar 900.000 lekë shtesë nuk do të jenë të detyruar ta respektojnë këtë angazhim.

Në këtë situatë, 1 milion lekë të arkëtuara në mjete monetare do të njihen si aktiv i kufizuar në këtë periudhë. Kufizimi është që kontributi duhet të përdoret për rinovimin e objekteve, jo për qëllime të tjera. Ndërsa vlera 900.000 lekë duhet të raportohet si një premtim i kushtëzuar për t'u marrë. Deri në arritjen e objektivit prej 2 milion (në mjete monetare dhe premtime për t'u marrë), anëtarët nuk janë të detyruar të bëjnë pagesa shtesë. Arritja e është 'një ngjarje e ardhshme e caktuar dhe e pasigurtë' siç referohet në objektivit paragrafin 92 të standardit.

ANEKS 1 – SHEMBULL KOMPLEKS

Ky shembull ilustron trajtimin e një sërë transaksionesh dhe ngjarjesh ekonomike të një organizate bamirësie, por të paraqitura në këtë shembull përmes bilancit vërtetues.

Aktiviteti kryesor i kësaj organizate bamirësie është sigurimi i shërbimeve të terapisë për refugjatët të cilët janë zhvendosur nga vendi i tyre. Organizata gjithashtu paraqet ekspozita arti, duke përdorur punën e krijuar nga refugjatët dhe arte nga burime të tjera.

Bilanci Vërtetues i organizatës bamirëse më 31 Dhjetor 20XX

| | Debi | Kredi |
|--|-----------------|-----------------|
| | <i>000 lekë</i> | <i>000 lekë</i> |
| Toka | 7.000 | |
| Ndërtesa | 22.000 | |
| Amortizimi i akumuluar i ndërtesave | | 15.000 |
| Pajisje | 2.200 | |
| Amortizimi i akumuluar i pajisjeve | | 500 |
| Investime afatgjata | 2.800 | |
| Inventar | 400 | |
| Të akëtueshme | 200 | |
| Mjete monetare | 1.200 | |
| Të pagueshme | | 2.100 |
| Aktive të pakufizuara më 1/1/XX | | 12.800 |
| Aktive të kufizuara më 1/1/XX | | 2.500 |
| Kontributet –të pakufizuara | | 12.200 |
| Grande të arkëtuara | | 2.400 |
| Tarifa të aktiviteteve bamirëse | | 4.500 |
| Të ardhura nga aktivitetet tregtare | | 2.000 |
| Shpenzime nga aktivitetet tregtare | 500 | |
| Të ardhura nga investimet –aktive të pakufizuara | | 200 |
| Të ardhura nga investimet –aktive të kufizuara | | 100 |
| Shpenzime bamirësie të klasave të terapisë | 12.000 | |
| Shpenzime bamirësie të ekspozitës | 4.000 | |
| Shpenzime të aktiveve të kufizuara | 700 | |
| Të tjera shpenzime | 1.300 | |
| | 54.300 | 54.300 |

Shënime dhe informacion shtesë

1. Amortizimi për vitin 20XX është llogaritur: 700 lekë për ndërtesat dhe 440 lekë për pajisjet. Shpenzimet e amortizimit duhet të ndahen 75% për klasat e terapisë dhe 25% për ekspozitat.
2. Shuma e granteve të arkëtuara prej 2.400,000 lekësh në bilancin vërtetues përfshin një grant prej 500.000 lekësh të arkëtuar nga një trust ndërkombëtar. Granti duhet të përdoret për blerjen e veprave të artit nga artistët lokalë. Në fund të vitit, asnjë nga këto grante nuk ishte përdorur.
3. Shpenzimet e aktiveve të kufizuara në bilancin vërtetues janë përdorur për të financuar konsulentët për të ndihmuar me orët e terapisë gjatë vitit.
4. Organizata bamirëse përdor vullnetarët si ciceronë për ekspozitat e saj si dhe për të kryer detyra administrative lidhur me aktivet e kufizuara. Përdorimi i punonjësve për këtë punë do të kushtonte rreth 1.000.000 lekë shtesë në vitin 20XX. Vetëm 10% e punës vullnetare ka të bëjë me aktivet e kufizuara.
5. Organizata e bamirësisë trashëgoi një koleksion veprash arti nga një ish-kryetar i saj. Koleksioni është me vlerë 1.5 milionë lekë dhe duhet të vihet në shfaqje të përhershme për publikun. Organizata e bamirësisë ka një politikë të kapitalizimit të aktiveve të tilla, por nuk ka një politikë që nënkupton kufizime kohore për aktivet.
6. Vlerësimi i investimeve në fund të vitit ka identifikuar fitime të porealizuara prej 300.000 lekësh dhe humbje prej 200.000 lekësh. Të gjitha fitimet dhe humbjet e porealizuara lidhen me aktivet e pakufizuara.
7. Deri më 31 dhjetor 20XX, shumën prej 600.000 lekë të aktiveve të kufizuara do të riklasifikohet si e pakufizuar, si rezultat i përmbushjes së kufizimit që ishte vendosur nga donatorët.

Pasqyra e aktiviteteve të organizatës së bamirësisë për vitin që mbaron më 31/12/20XX

| | | Aktive të pakufizuara | Aktive të kufizuara | Total |
|---|-----------|-----------------------|---------------------|-----------------|
| | | 000 lekë | 000 lekë | 000 lekë |
| <i>Të ardhura, fitime dhe ndihma të tjera:</i> | | | | |
| Kontributet | Tabela 1 | 14.600 | 100 | 14.700 |
| Grandet | | 1.900 | 500 | 2.400 |
| Tarifat | | 4.500 | | 4.500 |
| Të ardhura tregtare | | 2.000 | | 2.000 |
| Të ardhura nga investimet | | 200 | 100 | 300 |
| Totali i të ardhurave | | 23.200 | 700 | 23.900 |
| Fitimet nga investimet | Shënimi 6 | 300 | | 300 |
| Aktivet neto të çliruara nga kufizimi | Shënimi 7 | 600 | (600) | 0 |
| Totali i të ardhurave, fitimet dhe ndihma të tjera | | 24.100 | 100 | 24.200 |
| <i>Shpenzimet dhe humbjet:</i> | | | | |
| Klasat e terapisë | | 12.000 | 700 | 12.700 |
| Klasat e terapisë | | 4.000 | | 4.000 |
| Ekspozitat | | 500 | | 500 |
| Aktivite tregtare | | | | |
| Të tjera shpenzime | Tabela 2 | 3.055 | 385 | 3.440 |
| Totali i shpenzimeve | | 19.555 | 1.085 | 20.640 |
| Humbjet nga investimet | Shënimi 6 | 200 | | 200 |
| Totali i shpenzimeve dhe humbjet | | 19.755 | 1.085 | 20.840 |
| | | | | |
| Ndryshimet në aktivet neto | | 4,345 | (985) | 3.360 |
| Aktivet neto në fillim të vitit | | 12,800 | 2.500 | 15.300 |
| Aktivet neto në fund të vitit | | 17,145 | 1.515 | 18.660 |

Pasqyra e pozicionit financiar të organizatës bamirëse më 31 Dhjetor 20XX

| | | | |
|-------------------------------|--------------|-------|---------------|
| <i>Aktive aftagjata</i> | | | |
| Toka, Ndërtesa dhe pajisje | shënimi 1, 5 | | 16.060 |
| Investimet | shënimi 6 | | 2.900 |
| <i>Aktivet afatshkurtra</i> | | | |
| Inventari | | 400 | |
| Të arkëtueshme | | 200 | |
| Mjete monetare | | 1.200 | |
| | | | 1.800 |
| <i>Detyrimet afatshkurtra</i> | | | |
| Të pagueshme | | | (2.100) |
| Aktivet neto | | | 18.660 |
| Aktivet e pakufizuara | | | 17.145 |
| Aktivet e kufizuara | | | 1.515 |
| Aktivet neto | | | 18.660 |

Tabela 1 - Kontributet

| | Të pakufizuara | Të kufizuara | Totali |
|---|----------------|--------------|--------|
| Kontribute direkte | 12,200 | | 12,200 |
| Vullnetare (Shënimi 4) | 900 | 100 | 1,000 |
| Koleksione nga trashëgimitë (Shënimi 5) | 1,500 | 100 | 1,500 |
| | 14,600 | 100 | 14,700 |

Tabela 2 – Shpenzime të tjera

| | Të pakufizuara | Të kufizuara | Totali |
|-------------------------|----------------|--------------|--------|
| Shpenzime direkte | 1,300 | | 1,300 |
| Amortizimi | 855 | 285 | 1,140 |
| Vullnetarët (Shënimi 4) | 900 | 100 | 1,000 |
| | 3,055 | 385 | 3,440 |

ANEKS 2 – PEMA E VENDIMIT

